

FAQ - Albanian

Çfarë është SocialCard?

SocialCard është një kartë debiti Visa. Ajo nuk ndryshon as nga funksionaliteti as nga dizajni i kartave të tjera të debitit Visa, të cilat lëshohen nga institucionet e kreditit. SocialCard është e disponueshme si kartë plastike ose si kartë dixhitale për përdorimin në një smartfon.

Ku mund ta porosis SocialCard? Prej kujt e marr një SocialCard?

Ju nuk mund ta porosisni SocialCard. Vetëm komunat dhe autoritetet, të cilat përdorin SocialCard, mund ta lëshojnë kartën.

Ku mund të paguaj me SocialCard?

Ju mund të paguani kudo me SocialCard tuaj, atje ku shikoni logon e Visa: në dyqane në vendin ku jeni – në mbi një milion shitës në Gjermani.

Kini parasysh:

Zyra e lëshimit të kartave (p.sh. Zyra e Çështjeve Sociale) mund ta kufizojë përdorimin e kartës suaj në rajone të caktuara. Zyra e lëshimit të kartave ju informon për këtë në rastin e dhënies së kartës.

Unë kam një kartë plastike. Si mund të paguaj me SocialCard time në dyqan?

Mbajeni kartën tuaj në distancë prej pak centimetrash te terminali i pagesës. Në parim, mbani gati kodin tuaj PIN, të cilin duhet ta futni nëse është e nevojshme tek terminali i pagesës. Në rastin e shumave të vogla futja e kodit PIN sipas rastit mund të mos jetë e nevojshme. Pagesa e suksesshme konfirmohet nëpërmjet sinjalit akustik ose optik.

Unë kam një kartë dixhitale. Si mund të paguaj me SocialCard time në dyqan?

Për të paguar me kartën dixhitale, thjesht përdorni Apple Pay ose Google Pay.

A mund ta përdor kartën time plastike edhe me Apple Pay ose Google Pay?

Po, kjo është e mundur. Hapni Apple ose Google Wallet dhe thjesht shtoni SocialCard tuaj sipas udhëzimeve në smartfonin tuaj.

Unë kam një kartë dixhitale. Si ta ngarkoj unë kartën në smartfonin tim?

Së pari, shkarkoni "aplikacionin secupay" në smartfonin tuaj:

[iOS/Apple: App Store](#)

[Android/Google: Play Store](#)

Pas shkarkimit hapni "aplikacionin secupay". Juve ju kërkohet një herë e vetme për të regjistroheshi në "aplikacionin secupay" me numrin tuaj të telefonit dhe të përcaktoni një fjalëkalim për hapjen e "aplikacionit secupay". Përdorni këtu numrin e telefonit, të cilin e keni dhënë në zyrën e lëshimit të kartave. Për të përfunduar regjistrimin, ju merrni një SMS me një kod gjashtë-shifror regjistrimi. Futeni këtë kod në "aplikacionin secupay".

Pas regjistrimit të suksesshëm karta juaj dixhitale shfaqet direkt në "aplikacionin secupay". Në mënyrë që ta përdorni kartën, karta duhet aktivizuar. Për këtë qëllim, futni kodin e autorizimit si dhe kodin e kartës, të cilin e keni marrë nga ne veçmas nëpërmjet emailit. E-maili është dërguar në adresën e emailit, të cilën e keni dhënë në zyrën e lëshimit të kartave.

Karta juaj tani është e aktivizuar dhe gati për përdorim. Ju mund ta transferoni kartën nëpërmjet klikimit në Wallet të smartfonit tuaj dhe në mënyrë krejt komode nëpërmjet Apple Pay ose Google Pay.

Unë kam një kartë dixhitale. Unë nuk e kam marrë emailin me kodin e aktivizimit dhe me kodin e kartës.

Së pari, shikoni nëse ndoshta emaili gjendet në dosjen SPAM. Dërguesi i emailit është "no-reply@socialcard.de". Nëse atje nuk gjeni asnjë email, [atëherë mund ta dërgoni përsëri këtë e-mailin](#). Kinin parasysht që ne i dërgojmë të dhënat vetëm në adresën e emailit, të cilën e keni dhënë në zyrën e lëshimit të kartave (p.sh. Zyra e Çështjeve Sociale).

Unë kam një kartë dixhitale. Ku mund ta shkarkoj unë "aplikacionin secupay"?

[iOS/Apple: App Store](#)

[Android/Google: Play Store](#)

Unë kam një kartë plastike. A mund të përdor gjithashtu "aplikacionin secupay"?

Ju mund ta përdorni "aplikacionin secupay" vetëm nëse i keni dhënë zyrës së lëshimit të kartave (p.sh. Zyra e Çështjeve Sociale) në rastin e regjistrimit një adresë emaili dhe një numër telefoni.

Ku mund të tërheq para në kesh me SocialCard time?

Bankomati: Ju mund të tërhiqni para kesh në çdo bankomat. Në rastin e kartave plastike për këtë ju nevojitet kodin juaj PIN. Në rastin e kartave dixhitale, bankomati duhet të jetë i aftë për NFC dhe operatori duhet të pranojë kartën tuaj dixhitale Visa.

Tregti me pakicë: Ju mund të tërhiqni para kesh në shumë dyqane në kuadër të blerjes suaj. Kjo është falas për ju. Mbani parasysh që shpesh herë është i nevojshëm një shpenzim i vogël minimal, për të përdorur shërbimin e parave në kesh kur bëni blerje. Se në cilat dyqane është e mundur kjo gjë, [mund të kërkonti këtu online](#).

Sa para në kesh mund të tërheq me SocialCard?

Limitin e pagesave në para në kesh e përcakton zyra e lëshimit të kartave (p.sh. Zyra e Çështjeve Sociale). Zyra e lëshimit të kartave ju informon në rastin e lëshimit të kartës për kufizimet e mundshme në para kesh.

Sa kushton, nëse tërheq para kesh në bankomat?

Nëse tërhiqni para nga bankomati me SocialCard tuaj, atëherë për këtë ju tarifohet një tarifë fikse prej 2,00 EUR direkt nga krediti juaj, pavarësisht nga shuma që tërhiqni. Nëse ju për shembull tërhiqni 50,00 EUR, atëherë ju tarifohen 52,00 EUR.

A mund të paguaj unë me SocialCard time në internet?

Zyra e lëshimit të kartave (p.sh. Zyra e Çështjeve Sociale) ju informon në rastin e dhënies së kartës, nëse pagesat në internet janë të mundura me SocialCard tuaj.

Si mund të paguaj unë me SocialCard time në internet?

Zgjidhni në Checkout të dyqanit online pagesën me kartën Visa. Më pas juve ju kërkohet, të futni numrin e kartës suaj dhe vlefshmërinë e kartës. Për arsye sigurie ju duhet të konfirmoni pagesat online duke futur një të ashtuquajtur TAN. Ky TAN ose ju dërgohet me SMS ose ju shfaqet në "aplikacionin secupay".

Kini parasysh: Ju mund ta përdorni SocialCard tuaj vetëm për pagesën në internet, nëse në rastin e regjistrimit keni dhënë adresën tuaj të emailit dhe numrin tuaj të telefonit. Një regjistrim i mëvonshëm i këtyre të dhënave nuk është i mundur.

Ku mund të pyes, se sa kredit kam në SocialCard time?

Gjendjen e kreditit tuaj [mund ta kërkonti këtu online](#). Nëse përdorni "aplikacionin secupay", juve ju shfaqet atje krediti aktual.

Ku mund të pyes, se çfarë kam paguar me SocialCard time?

Transaksionet që keni bërë mund t'i shihni online. Kontrollin e transaksioneve [e gjeni këtu](#).

Nëse përdorni "aplikacionin secupay", mund të kontrolloni edhe atje transaksionet që keni bërë.

Unë e kam humbur smartfonin tim, në të cilin është ruajtur karta dixhitale. Kush më ndihmon më tej?

Ne ju lutemi ta bllokoni smartfonin tuaj nëpërmjet Apple ose Google.

[Apple \(iOS\)](#)

[Google \(Android\)](#)

Nëse keni një smartfon të ri, ju mund ta aktivizoni këtu kartën dixhitale. Shkarkoni "aplikacionin secupay" dhe ndiqni udhëzimet e aplikacionit. Të dhënat përkatëse (kodin e autorizimit dhe kodin e kartës) i merrni [këtu online](#).

Unë kam humbur kartën time plastike. Kujt t'i drejtohem?

Ju mund ta bllokoni direkt [këtu online](#) kartën tuaj ose kontaktoni zyrën e lëshimit të kartave (p.sh. Zyra e Çështjeve Sociale). Atje merrni edhe një kartë zëvendësimi.

Unë kam harruar kodin PIN për kartën time plastike. Kush më ndihmon më tej?

Kodin tuaj PIN mund ta kërkonti [këtu direkt online](#).

Unë kam futur shpesh kodin e gabuar PIN. Karta ime është bllokuar. Kush më ndihmon më tej?

Ju mund të kontaktoni zyrën e lëshimit të kartave (p.sh. Zyra e Çështjeve Sociale) ose përdorni formularin tonë të kontaktit. Specifikoni atje që ju nevojitet një kod i ri PIN. Ne e zhblllokojmë kartën tuaj dhe ju dërgojmë një SMS ose email me informacionet, se si të merrni kodin e ri PIN.

Kush më ndihmon, nëse kam një problem me SocialCard time?

Përdorni [formularin e kontaktit](#), për të na drejtuar pyetjet tuaja.

A mund ta transferoj kreditin në SocialCard?

Jo, kjo nuk është e mundur. Vetëm zyra e lëshimit të kartave mund ta transferojë kreditin në kartën tuaj.

A mund të bëj transferta nga SocialCard ime?

Jo, kjo nuk është e mundur.

Ku mund ta gjej marrëveshjen aktuale të vlefshme të përdoruesit të kartës?

Kushtet aktuale të vlefshme të përdorimit i gjeni direkt në "aplikacionin secupay" ose [mund t'i shkarkoni këtu](#).